



## SUPPORTING EMPLOYMENT OF YOUNG PEOPLE



This project is funded by the European Union

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, në suaza të jetësimit ekzistues të projektit “Mbështetja e punësimit të të rinjve“, të financuar nga BE-ja, bën

### **SHPLLJE PUBLIKE përpërfshirjen e punëdhënësve në masën “Prakticiteti”**

Të gjithë punëdhënësit (subjektet juridike të regjistruara) që janë të interesuar për t'u mundësuar të rinjve të moshës deri 29 vjet, që të fitojnë njohuri dhe aftësi praktike si praktikantë, në periudhën maksimum 3 muaj, u bëhet thirrje për të marrë pjesë nëpërmjet dorëzimit të aplikacioneve në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë. Numri i përgjithshëm i praktikantëve të cilët mund të angazhohen në suaza të projektit, është 1000 veta.

#### o **Përshkrimi i praktikitetit**

Praktikantët do të jenë të rinj deri në moshën 29 vjet, së paku me përgatitje shkollore të mesme, të regjistruar si të papunë, si kërkues aktiv të punës në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë pa përvojë pune paraprake bazuar në arsimimin e tyre.

Secili kandidat i zgjedhur si praktikant do të nënshkruajë marrëveshje tremujore për praktikitet me Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë, ku do të përcaktohen kushtet, të drejtat dhe detyrimet e hollësishme. Stërviija praktike mund të bëhet me turne, por nuk mund të zgjasë më vonë se ora 22 dhe të fillojë para orës gjashtë.

Punëdhënësi duhet të nominojë një mentor i cili do të japë udhëzime adekuate për punën e praktikantit dhe do të informojë për rregullsinë e praktikantit gjatë kohës së punës praktike. Shpenzimet për kompensim mujor për praktikitet në shumën prej 6.261,00 denarë i përfshirë sigurimi në rast fatkeqësie gjatë punës dhe tatimi personal i të ardhurave për secilin praktikant, do të mbulohen nga ana e projektit të financuar nga BE-ja.

#### o **Kriteret e zgjedhjes**

Punëdhënësit duhet t'i plotësojnë parakushtet siç vijojnë:

1. Punëdhënësi duhet të jetë subjekt juridik dhe të mos jetë institucion shtetëror apo publik;
2. Punëdhënësi të ketë së paku dy persona të punësuar;
3. Punëdhënësi t'i ketë paguar të gjitha obligimet tatimore, si dhe kontributet për sigurimin social për të punësuarit e tij para se të dorëzojë kërkesën për aplikim;
4. Numri maksimal i praktikantëve të cilët mund të pranohen te punëdhënësi varet nga numri i të punësuarve:
  - a) 1 (një) praktikant – nëse numri i përgjithshëm i të punësuarve te punëdhënësi është deri 4 (katër) veta;
  - b) 2 (dy) praktikantë – nëse numri i përgjithshëm te punëdhënësi është 10 (dhjetë) veta;
  - c) Deri 5 (pesë) praktikantë – nëse numri i përgjithshëm te punëdhënësi është mbi 10 (dhjetë) veta;
  - ç) Deri 20 praktikantë – nëse numri i përgjithshëm i të punësuarve te punëdhënësi është mbi 100 (njëqind) veta.

Subjektet juridike nga sektori privat janë të kualifikuar për të marrë pjesë në Programin e praktikitetit. Pjesëmarrja në organizatat joqeveritare është e pranueshme nëse ato kanë të paktën një person të punësuar. Ato patjetër duhet të kenë (në mënyrë precize në statutin e tyre) ndonjë nga fushat e mëposhtme të veprimit: barazia gjinore; kundër të gjitha formave të dhunës familjare dhe mbrojtjen e vitimave; mundësitë të barabarta; kundërdiskriminimi; mbrojtja e fëmijëve; dhe socializimi i popullatës rome.

Gjatë kohës së procedurës së aplikimit, punëdhënësit që do të ofrojnë plan për praktikantët si pjesë e formularit për aplikim, si dhe detyra të punës nëpërmjet të cilave praktikantët mund të arrijnë aftësi dhe njohuri adekuate dhe do të udhëzojnë mentorin.

Pavarësisht nga kriteret e lartpërmendura, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë e ruan të drejtën e refuzimit për pjesëmarrje në Programin e praktikitetit, në bazë tjetër e cila nuk është përmendur në shpallje, si dhe në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit.





## SUPPORTING EMPLOYMENT OF YOUNG PEOPLE



This project is funded by the European Union

Nëse nuk ka konflikt të interesit ndërmjet punëdhënësit dhe praktikantit potencial, si afërsia farefisnore (prindër, bashkëshort, vëllezër, motra etj), punëdhënësi ka mundësi të propozojë praktikantë. Në rastet e veçanta, komisioni i evoluimit mund ta marrë parasysh praktikantin edhe përkundër ekzistimit të konfliktit direkt të interesit, vetëm nëse punëdhënësi nënshkruan dhe dorëzon aplikacion me arsyetim adekuat.

### o Procedura e aplikimit

Punëdhënësit e interesuar mund t'i dorëzojnë formularin e aplikimit dhe deklaratën, duke shprehur interesimin për pjesëmarrje në Programin e praktikitetit, përmes postës ose direkt në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë ose në ndonjë qendër të punësimit brenda shtetit, çdo ditë pune prej orës 8,30 deri 16,30.

Aplikacionet do të evoluohen çdo 20 ditë pune duke filluar nga dita e shpalljes së sotme.

Të gjithë punëdhënësit do të njoftohen me shkrim për rezultatet e evoluimit.

Çdo informacion i përfshirë në aplikacion do të trajtohet në besueshmëri.

**Aplikimi dhe deklaratata e punëdhënësit duhet të nënshkruhen dhe të vulosen nga ana e personit të autorizuar nga punëdhënësi. Gjatë dorëzimit të aplikacionit punëdhënësi duhet të nënshkruajë dhe vulojë aplikacionin e lëshuar nga qendra e punësimit.**

Deklarata përmban konfirmimin e pikës së tretë të kriterëve, si dhe të gjitha kriteret e lartpërmendura.

Para nënshkrimit të marrëveshjes, punëdhënësit do të jenë të obliguar që me deklaratë të nënshkruar ta konfirmojë se nuk ekziston konflikt interesi lidhur me personat që apikojnë për pjesëmarrje në Programin e praktikitetit.

Projekti “Mbështetja e punësimit të të rinjve” është financuar në suaza të Programit operativ për zhvillimin e burimeve nejrëzore 2007-2013 (IPA komponenti IV). Aktivitetet e projektit direkt ndihmojnë në arritjen e qëllimeve nga Plani operativ për masat aktive në tregun e punës për vitin 2017.

Shpallja publike po ashtu është publikuar edhe në ueb faqet siç vijojnë:

- Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë (APRM) [www.avrm.gov.mk](http://www.avrm.gov.mk);
- Ministria e Punës ndhe Politikës Sociale (MPPS) [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk);

